



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 43.1 dhe 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, neneve 5.1 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neneve 37 dhe 38 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, në Kërkesë të Kryetarit të Komunës nr.prot.02-060/03-0023958/24 të datës 12 prill 2024,

THËRRAS

Mbledhjen e XXXVII-të (tridhjeteshtatë - mandati VII)- e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **18 prill 2024, duke filluar në ora 10:00**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, me këtë:

REND DITE

1. Propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019.
2. Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK

Nr.Prot. 01-060/03-0023974/24
Podujevë, datë; 12 prill 2024



Kryetari i Kuvendit
Ftahi Hoxha,



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Për: Kuvendin e Komunës
z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit

Çështja: Kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që në bazë të nenit 44 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, me pikat e rendit të ditës si në vijim:

1. Propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019.
2. Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK

Sigurisht jeni të informuar se Ministria e Shëndetësisë ka marrë Vendim nr.prot.01-05-1942 të datës 19.03.2024 për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.05-7029 për Themelimin e Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë më datë 27.10.2016.

Ndërsa më datë 25.03.2024 Ministria e Shëndetësisë ka marrë Vendim nr.prot.05-2084 për Themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, duke i'u referuar Vendimit nr.05-1806 të datës 13.03.2024 për Miratimin e Planit të Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës në Podujevë.

Në këtë kontekst dhe me qëllim të funksionalizimit të Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, me Planin e Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës në Podujevë, kërkohet që Komuna e Podujevës të ndërmarr veprime konkrete me qëllim të krijimit të mundësive për zbatimin e Vendimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht është e nevojshme dhe rekomandohet të:

- Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-462/01-0075934/19 i datës 23.09.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, duke rekomanduar edhe shkëputjen e Kontratës nr.prot.02-016/01-0032267/20 datë 30.06.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

- Merrret Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Bashkëngjitur:

- Propozim Vendimi për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019, (së bashku me Vendimin e cekur dhe Kontratën përkatëse)

- Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, (së bashku me Vendimet e lartcekura dhe Kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë)

Nr.Prot. 02-060/03-0023958/24
Podujevë, datë; 12.04.2024





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 12.2 shkronja d), 14.1 dhe 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 27 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenin 22 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 53 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 12 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenet 17.1 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.prot.05-1942 të datës 19.03.2024 për shfuqizimin e vendimit nr.05-7029 të datës 27.10.2016 për themelimin e Spitalit të përgjithshëm në Komunën e Podujevës, Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.prot.05-1806 të datës 13.03.2024 për Miratimin e Planit të Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës në Komunën e Podujevës, Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

PROPOZON

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.PROT.01-462/01-007575934/19 TË DATËS 23.09.2019 PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË SHFRYTËZIM AFATGJATË SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS - SHSKUK

Neni 1

Shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-462/01-007575934/19 datë 23.09.2019 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit të cekur në nenin 1, bëhet mbi bazën dhe në funksion të zbatimit të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.prot.05-1942 datë 19.03.2024, sipas të cilit është shfuqizuar vendimin nr.prot.05-7029 datë 27.10.2016 për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës.

Neni 3

I rekomandohet Kryetarit të Komunës shkëputja e Kontratës nr.prot.01-016/01-0032267/20 datë 30.06.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, e lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Me këtë vendim njoftohen:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministria e Shëndetësisë

SHSKUK

Drejtoritë e Komunës

Nr.Prot.02-462/01-0023967/24
Podujevë, datë: 12.04.2024

